

# VENDIMET MERREN



# NGA NE


## FËMIJËT NË DEMOKRACI

ISLAM (10), DRILON (10), RINESA (10), ALBANA (10), ERONA (10), ARJANIT (10), ERDIN (10)

Ne, nxënësit e klasës V-2 nga shkolla fillore „Andon Zako Çajupi“, kemi ardhur sot në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“, ku patëm rastin të diskutojmë për shumë gjëra në lidhje me demokracinë

Të dashur lexues, shpresojmë që do t'iu pëlqejë artikulli ynë për demokracinë. Gjatë diskutimit tonë në grup, kemi shprehur lirshëm mendimet tona. Duke pasur parasysh se në demokraci të gjithë jemi të barabartë, secili prej nesh i kemi ndarë rolet në mënyrë demokratike. Për shembull, disa nga ne dëshironin të vizatonin, disa të shkruanin idetë e tyre për artikull, disa të shkruanin në laptop, etj. Gjatë punës sonë grupore, po ashtu kemi bashkëpunuar dhe kemi qenë tolerant me njëri-tjetrin. Pra, të drejtat tona për të zgjedhur gjërat që ne i pëlqejmë i kemi përdorur në mënyrën më të mirë të mundshme. Këtë e kemi bërë duke qenë të përkushtuar në punën tonë dhe duke e respektuar mendimin e secilit prej nesh.


Ne mësuam se fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull, dhe „kratia“ udhëheqje. Pra, demokracia është udhëheqje e popullit, prandaj çdo vendim që mirret nga populli ka ndikim në jetën e secilit.



Udhëheqja e popullit




Të drejtat tona mbrohen me ligj



Toleranca dhe solidariteti në demokraci



Grupi „7 Yjet“



Jemi të lirë dhe jetojmë në paqe

# KOSOVA, SHEMBULL I ZGJEDHJEVE TË MIRA

ERMAL (10), LORIK (10), BLENDI (10), ARDITI (9), ENIS (10), LAURA (10), BARDHA (10), ELSA (10)



## Ne jemi shtet i pavarur dhe demokratik, e pikërisht për këtë arsye shteti ynë Kosova organizon zgjedhje të lira dhe demokratike

Përshëndetje lexues të nderuar. Jemi ne, nxënësit e klasës V-2 që po e shkruajmë këtë artikull. Duam t'iu informojmë se sa demokratike janë zgjedhjet në Kosovë. Këtë raportim që po e bëjmë sot për ju, e kemi mbështetur në një rast specifik të cilin e kemi mësuar



nga një shoqe e klasës. Rasti në fjalë lidhet me zgjedhjet e fundit qendrore që janë mbajtur në Republikën e Kosovës. Babai i shoqes së klasës tonë ishte kandidat për deputet. Ai pasi që është bërë pjesë e procesit zgjedhor, duke kandiduar kështu për deputet, krijoi planprogramin e tij. Në atë planprogram ishin të shkruara të gjitha çështjet me rëndësi për popullin, të cilat më vonë do të diskutoheshin në Kuvend. Kuptohet nëse kandidati ynë do të arrinte të siguronte votat

e qytetarëve. Pas kësaj, planprogrami iu është paraqitur qytetarëve në mënyrë që ata të njoftohen dhe ta vlerësojnë kandidatin në fjalë dhe planprogramin e tij. Babai i shoqes së klasës nuk e kishte pasur të vështirë pjesëmarrjen në fushën politike. Kjo për arsye se për një kohë të gjatë ai dhe familja e tij kishin dhënë kontribut të madh për shtetin. Qytetarët u bazuan në kontributin e tyre të vazhdueshëm dhe u bazuan në vlerat personale të kandidatit. Kështu kur u mbajtën zgjedhjet, ai arriti edhe të dal fitues. Kjo nënkupton se ai arriti të bëhet deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai tani me shumë përkushtim i përfaqëson nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Këtë punë e realizon me shumë vullnet, sepse ai është i vetëdijshëm se vota demokratike e qytetarëve ka bërë që ai të ketë këtë rol.

Prandaj, qytetarë të dashur, përpara se të votoni mendoni mirë paraprakisht.



Së bashku e forcojmë demokracinë

## RREGULLAT NA BËJNË MË PËRGJEGJËS

EDONIS (10), ALBINA (11), YLBER (11), BLERONA (10), ELTON (11), ANJEZA (10), VALDRIN (10),

IMER (10)



### Siguria e qytetarëve është shumë e rëndësishme, prandaj në Kosovë ekziston ligji për sigurinë tonë

Sot është ditë shumë e veçantë, sepse nuk është si ditët e zakonshme që i kalojmë në shkollë. Ne kemi ardhur në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“. Këtu kemi folur për shumë gjëra duke filluar nga demokracia, ligjet dhe Kuvendi.

Diçka që na la shumë përshtypje, ishin rregullat të cilat ishin në këtë Punëtori. Nuk janë rregulla të panevojshme siç mund të mendoni ju. Janë rregulla të bazuara në elementet e demokracisë. Kemi respekt të ndërsjelltë, si rregull shumë me vend, sepse nëse duam të kuptojmë atë se çka flet secili prej nesh, ne duhet të dëgjojmë njëri-tjetrin. Pastaj, rregull tjetër ishte mënyra sesi të gjithë duhet të tregonim respekt ndaj njëri-tjetrit por edhe ndaj hapësirës ku zhvillohet punëtorja. Rregulla të filla të cilat i japin një kahje të mirë jetës sonë ka edhe në gjithë Kosovën. Këto rregulla quhen ligje.

Ligjet janë rregulla, të cilat miratohen nga deputetët të Kuvendit të Kosovës. Prandaj edhe themi se Kuvendi është institucioni më i lartë i shtetit tonë. Ligji i cili mund të na mbrojë nga rreziku i rrugëve, është ligji për komunikacion. Çka do të ndodhte nëse nuk do të ekzistonte ky ligj? Ne nuk do të shenja të komunikacionit të cilat e ndalojnë shpejtësinë në vende të banuara. Apo po të mos ishin semaforët në udhëkryq, nuk do të ishte e mundur të bëhej një koordinim në mes të

veturave nga të katër anët, por edhe të këmbësorëve. E gjithë kjo që ne e shkruajtëm tani në artikull, dëshmon se ligjet ekzistojnë për qëllime të mira.

Para se të miratohen ligjet në Kuvend, ato janë ende projektligje. Këto projektligje së pari kontrollohen nga komisionet e Kuvendit të Kosovës, e më pas kalojnë në votim. Projektligjet mund të propozohen nga Qeveria, deputetët, Presidenti, si dhe nga bashkimi i nënshkrimeve të 10.000 qytetarëve për një propozim të projektligjit.

Ç’është e vërteta, ne sot mësuam shumë gjëra, por më e shumta që ne kemi marrë sot këtu është kënaqësia. Kënaqësia e të qenurit i barabartë me të tjerët dhe respekti që të gjithë edukatorët tregonin ndaj nesh, na ka bërë të kuptojmë se vërtet demokracia është e vlefshme. Prandaj, duhet ta çmojmë dhe ta ruajmë atë si thesarin më të çmuar.



Rezultat i punës sonë si gazetarë është ky artikull

**Nëse qytetarët kanë dëshirën dhe vullnetin për të bërë ndryshime, ata mund ta bëjnë këtë gjë duke qenë pjesë e procesit zgjedhor dhe duke votuar për personat e duhur**



**Qytetarë aktiv është ai i cili voton**



**Kontributi ynë si qytetarë, nuk njih moshë, racë e as gjini**

Ligjet, për të cilat folëm në artikullin paraprak, thamë se bëhen për neve qytetarët. Këto ligje neve na bëjnë më të përgjegjshëm. Gjithashtu, na bëjnë të reflektojmë për atë se çka i duhet shtetit tonë për të qenë shtet edhe më i fuqishëm. Puna është ajo, me anë të së cilës arrihet çdo synim i yni.

Ne qytetarët e Kosovës, duhet të aktivizohemi. Ne duhet të përpiqemi që me forcat tona individuale, grupore dhe me njohurit tona që ne i posedojmë, të marrim iniciativa të ndryshme. Për shembull, ta ngrihim vetëdijen tek bashkëqytetarët tanë për rëndësinë e ambientit të pastër.


Si mund të ndodh kjo? Së pari ne duhet të kuptojmë se

gjendja jonë shëndetësore mund të përkeqësohet nga ambienti i papastër. Ne nuk duhet ti hudhim mbeturinat nëpër rrugë të qytetit apo nëpër lumenj. Mbeturinat duhet të hudhen në shporta.

Ne gjithashtu si qytetarë aktiv mund të marrim pjesë në tubime publike, të cilat realizohen me qëllim të vetëdijësimit qytetarë për çfarëdo lloj fushe.

Qytetarë aktiv na bën edhe pjesëmarrja jonë në procesin zgjedhor. Pse?

Nëse ne jemi të pakënaqur me qeverisjen e shtetit, duhet të dalim dhe të votojmë për ndryshimin e asaj qeveriseje. Në të kundërtën, në shtetin tonë nuk do të ketë mundësi për ndryshime.



**Një votë e jona, mund të bëjë ndryshime për të ardhmen**



**Bashkëpunim dhe respekt ka në grupin tonë**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Andon Zako Çajupi“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri